

VENDIM
Nr.1076, datë 21.10.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS QENDËR TEPELENË TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qendër Tepelenë të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Qendër Tepelenë, të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.69, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Qendër Tepelenë të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Qendër Tepelenë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
Lidhja nr.1

Komuna Qendër Tepelenë

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
400-402	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
403	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
404	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
405-605	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
606-617	Varrezat publike	Në pronësi
618-624	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
675	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
744-775,777-798,800-815,817-832,834-864,866-890,904-925,927-967,969-1019,1021-1034,1036-1049	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
1050-1051,1054-1055,1058-	Prona që përdoren për ushtrimin e	Në

1059,1063-1064,1068-1069,1073-1074,1078,1081-1082,1086-1087,1090-1091,1095-1096,1101-1102,1105-1106	funksiioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	përdorim
1052-1053,1056-1057,1060-1062,1065-1067,1070-1072,1075-1077,1079-1080,1083-1085,1088-1089,1092-1094,1097-1100,1103-1004,1107-1108,632,649,651,653,657,660,663,667,669,672,674	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi